

I Nr. 86 Dt. 05/03/2010
PRISHTINË-A



Për: Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Zyrës së
Rregullatorit për Energji
I Hamdi Mramori,
Prishtinë 10000

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Arben Gjukaj
Drejtore Menaxhues KEK sh.a
Ndërtesa Elektrokosovës
Bulevardi Bill Clinton
Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
www.kek-energy.com

ME DORË DHE EMAIL

Data: 5 Mars 2010

Lënda: Përgjigjet e KEK-ut në Raportin Konsultativ të ZRrE-së

I nderuar Profesor Hamiti,

Bashkangjitur janë përgjigjet e KEK-ut në Raportin Konsultativ të Shqyrtimit të Katërt Tarifor të Energjisë 2010 të dërguar nga ZRrE-ja me 26 Shkurt 2010. KEK-u falënderon ZRrE-në për dhënien e mundësisë për të ju përgjigjur çështjeve të rëndësishme të ngritura nga ZRrE-ja në këtë raport konsultativ dhe kërkon që pozita e KEK-ut në çështjet e ngritura të konsiderohet seriozisht para se të caktohen tarifat të cilat hyjnë në fuqi me 1 Prill 2010.

Unë e kuptoj që shumica e çështjeve të ngritura përfshijnë çështje komplekse dhe analiza dhe unë ju inkurajoj juve dhe stafin e juaj që të bashkëpunoni me Zyrën e Rregullatorit të KEK-ut për të qartësuar cilëndo çështje në përgjigjet e dhëna nga KEK-u si dhe aspektet tjera të këtij shqyrtimi tarifor.

KEK-u mirëpret që të shqyrtoj të gjitha komentet e marruara nga Aksionarët rreth Raportit Konsultativ. KEK-u shpreh dëshirë dhe është i gatshëm të marrë pjesë në çfarëdo forumi publik të sponsoruar nga ZRrE-ja në lidhje me këtë shqyrtim tarifor.

Raporti Konsultativ ka adresuar vetëm çështjen e të Hyrave të Lejuara. Nuk ka pasur kurrfarë komenti në pozitën e KEK-ut për alokimin e kostove sipas klasave të konsumatorëve ose dizajnimin e tarifave në mënyrë që të lëvizim drejt tarifave kosto reflektuesve për secilin klasë tarifore. KEK-u shpreson që do të ketë mundësinë për të komentuar në këto çështje të rëndësishme para se të dorëzojë ZRrE-ja orarin final të tarifave.

Me nderime,

Arben Gjukaj
Drejtore Menaxhues

Bashk. Përgjigjet e KEK-ut në Raportin Konsultativ



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Korporata Energjetike e Kosovës Sh. a

Përgjigjet e KEK-ut ndaj Dokumentit të Konsultimit të ZRRë-së

Dorëzuar më 05 mars 2010

Kjo është përgjigjja e KEK-ut për çështjet e ngritura në Dokumentin Konsultimit të ZRRë-së dhe një kërkesë për ZRRë-në për informata shtesë për disa rregullime të paidentifikuara të bëra për të Hyrat e Lejuara të propozuara të KEK-ut. Për qartësi dhe transparencë, KEK-ut ka përgatitur Tabelën 1 për të bërë të mundur një krahasim të pozicionit të ZRRë-së me aplikacionin për tarifa të KEK-ut për secilën komponent të kostos. Vlerat në pozicionet e ZRRë-së janë ato që përfshihen në tabelën 3 të Dokumentit të Konsultimit. Kjo përgjigje fokusohet në dallimet e rëndësishme ndërmjet qëndrimit të KEK-ut dhe qëndrimin e ZRRë-së.

Tabela 1: Krahasimi i Të ardhurat e lejuara të kërkuara nga KEK-ut dhe Pozicionit të ZRRë - (Mijera Euro)

| Line No. | Pershkrimi | Aplikacioni i KEK-ut per Tarifa | | | | | Total KEK | ERO POZICIONI |
|----------|--|---------------------------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|----------------|------------------|
| | | Mihjet | Gjenerimi | Rrjeti | Furnizimi | | | |
| 1 | Shpenzimet Operative | 42,244.0 | 30,801.8 | 18,714.0 | 10,103.3 | 101,863.1 | 106,601 (1) | |
| 2 | Zhvlerësimi | 5,571.8 | 4,202.4 | 1,051.1 | 507.2 | 11,332.5 | 12,104 | |
| 3 | Kthimi | 18,838.3 | 8,786.8 | 4,237.6 | 308.2 | 32,171.0 | 24,143 | |
| 4 | Margjina e Furnizimit | | | | 4,015.5 | 4,015.5 | (1) | |
| 5 | Importi | | | | 25,539.6 | 25,539.6 | 19,990 | |
| 6 | Blerjet në Nivel të Distribucionit | | | | 2,818.4 | 2,818.4 | 2,581 | |
| 7 | Pagesa e KOSTT-it | | 5,813.0 | | 16,135.7 | 21,948.7 | 12,497 (2) | |
| 8 | Shitjet e Energjisë te KOSTT për Humbje | | | | -5,339.8 | -5,339.8 | (2) | |
| 9 | Të Hyrat nga Konsumatorët e Privilegjuar | | | | -21,281.2 | -21,281.2 | -22,112 | |
| 10 | Shpenzimet e Borxhit të Keq | | | | 3,160.0 | 3,160.0 | 0 | |
| 11 | Të Hyrat tjera Operative | -1,500.0 | | | | -1,500.0 | -1,500 | |
| 12 | Eksporti | | | | -4,429.8 | -4,429.8 | -4,430 | |
| 13 | Shpenzimet e HQ | 5,045.9 | 2,399.4 | 1,768.3 | 1,750.6 | 10,964.1 | 11,164 | |
| 14 | Sherbimet ndihmese | | | | | | -1,624 | |
| 15 | Azhustimet | | | | | | -3,187 | |
| | Shuma Totale e Të Hyrave të Lejuara | 70,200.0 | 52,003.4 | 25,770.9 | 33,287.8 | 181,262.1 | 156,229 | |

SHENIM: (1) ZRRë-ja ka përfshirë Margjinën e Furnizimit (me sa duket në 4.988 Milion Euro) në OPEX (linja 1); KEK e ka përfshirë në linjen 4 (2) ZRRë-ja ka grumbulluar të gjitha pikat e Transmisionit në linjen 7, ndërsa KEK ka përfshirë shpenzimet në linjen 7 dhe të hyrat në linjen 8

ÇËSHTJA : Kthimi

Siç tregohet në tabelën e bashkangjitur, ZRRë-ja propozon një lejim për kthimin e € 24.1 Milionë, kundrejt kërkesës së KEK-ut prej € 32.2 Milionëve, një ndryshim prej € 8 Milion. Ky ndryshim është për shkak të 3 faktorëve:

- Azhustimi i shpenzimeve kapitale në aplikacionin paraprak të 2009 të KEK-ut për vlerën aktuale. Kjo rezulton në një reduktim prej 2.3 Milion €. KEK-u pajtohet me këtë rregullim.

- Një ndryshim në Normën e Kthimit nga 13,8% në 13,1% për të reflektuar një ndryshim në normën e tatimit mbi fitimin nga 20% në 10%. Ky rregullim ka reduktuar të ardhurat e lejuara për 1.6 Milion € dhe është konsideruar e përshtatshme duke marrë parasysh ndryshimin në normën tatimore meqë norma fillestare e kthimit është caktuar në vendim paraprak të tarifave.
- ZRrE-ja ka analizuar dhe përshtatur bazën e aseteve si rezultat i shqyrtimit të tyre të pasqyrave financiare të 2006-2008. KEK-u është duke shqyrtuar letrat punës të dërguara nga ZRrE-ja. Edhe pse në thelb analiza duket e saktë, duket se ZRrE-ja nuk ka arritur të konsiderojë llogarinë e "Përparësitë për Furnizuesit" të përfshirë në pasqyrat e audituara financiare të 2008. Përparësitë për furnizuesit përfaqësojnë pagesa të bëra në lidhje me projektet kapitale për pajisje kapitale për kohë të gjatë (rotor për turbinë, rotor për gjenerator, etj) dhe në fakt janë shpenzime kapitale edhe pse pajisjet ende nuk ishin në vend punishte në fund të vitit 2008. Pjesa që kanë të bëjnë me pajisjet për Miniera nuk është e përshtatshme për të përfshirë në Asetet Baze të Rregulluara meqë financimi i tij ishte i lidhur nga grantet ndërsa shuma që kanë të bëjnë me projekte kapitale të Gjenerimit (€ 12.6 Milion) është financuar me kredi apo fonde të KEK-ut. Sigurisht që paratë janë shpenzuar nga KEK-u, shumica prej të cilëve erdhën nga kreditë, dhe KEK-u është i obliguar të paguajë interes. Shuma duhet të shtohet në Asetet Bazë të Rregulluara si dhe shuma e Rrjetit në vlerë prej € 1.7 Milion. Që nga 2010 të gjitha pajisjet relevante janë dorëzuar. Dështimi për të përfshirë këtë artikull në Asetet Bazë të Rregulluara të do të thotë se KEK-u nuk do të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e saj për shërbimin ndaj borxhit. Kjo e ngritë Asetet Bazë të Rregulluara (RABf) për 14.314.000 € një pjesë të llogarive të Përparësive për Furnizuesit të paraqitura në pasqyrat financiare të audituara më 31 dhjetor 2008 në lidhje me CAPEX projektet e Gjenerimit (€ 12.573.000) dhe Rrjetit (€ 1,741,000) që nuk janë financuar nga grantet. Shfrytëzimin e 13,1% të normës së kthimit të propozuar nga ZRrE-ja, komponenta e Kthimit e të Ardhurave të Lejuara, duhet të rritet për € 1.875.000..

ÇËSHTJA: Sasitë e importit dhe çmimet

A. Importet Jo-emergjente:

KEK-u i ka dhënë ZRrE-së (sipas një marrëveshje konfidencialiteti) orarin e saj të detajuar të sasive të importit dhe çmimeve të llogaritura për çdo periudhë të vitit 2010. Sasitë janë në përputhje me Bilancin e Energjisë për sektorin. ZRrE-ja ka shqyrtuar materialin dhe tregon se llogaritja e tyre e çmimit mesatar të importeve jo-emergjente për vit është 69,5 € për MWh në krahasim me të dhënat e KEK-ut prej 71,1 € për MWh. Meqë çmimi për çerekun e dytë deri në të katërtin është një parashikim, kjo është e vështirë për të argumentuar në lidhje me një ndryshim 2,3% të çmimit. Ky rregullim zvogëlon të hyrat e lejuara të KEK-ut për € 1.4 Milion.

B. Importet Emergjente

ZRrE-ja ka rregulluar vlerën për importet emergjente të KEK-ut nga € 14.4 Milion € në 10.2 Milion Euro, një zbritje prej € 4.2 Million apo (29%). ZRrE-ja nuk i ka ofruar KEK-ut detajet e llogaritjeve të saja të reduktimit. Përmendet se është bërë që çmimi i vlerësuar i KEK-ut për kontratat 72 orë-she ishte shumë i lartë, por ZRrE-ja nuk dha vlerësim të tyre të çmimeve.

ZRrE-ja gjithashtu deklaroi se ata do të ulin sasinë e supozuar për energjinë e importuar për kontratat 6 orë-she, por sasia e reduktimit nuk u deklarua. Arsyeja ZRrE-së për reduktimin ishte se konsumatorët në kategoritë A dhe B, duhet të kenë

reduktive në të njëjtën masë si kategoria C. Kjo është në kundërshtim me qëllimin e vendimit të 29 nëntorit 2005 që aprovoi programin ABC të KEK-ut që theksonte:

“KEK do të perpiqet të përmbajë orarin e reduktiveve sipas:

- *24:0 për daljet e kategorisë A*
- *5:1 për daljet e kategorisë B*
- *4:2 ose më keq për daljet e kategorisë C”*

Duket e çuditshme që ZRrE-ja do të zvogëlojë sasinë e energjisë emergjente të importuar për vitin 2010 dhe të thotë se KEK-u duhet të aplikoj reduktive ndaj konsumatorëve A dhe B (pagesit më të mirë) më shpesh. KEK-u nuk pajtohet me reduktimin € 4.2 Milion.

ÇËSHTJA: Shpenzimet e Shërbimit të Transmisionit të KOSTT

Në Dokumentin e Konsultimit ka shumë pak qartësi në lidhje me shumën që do të përfshihet në të Ardhurat e Lejuara të KEK-ut në lidhje me shërbimet e transmisionit. Në buxhetin e saj të 2010, KEK-u ka aplikuar tarifën e tanishme të KOSTT-it për të llogaritur prodhimin, shpërndarjen e energjisë, dhe të dhënat e ngarkesës së pikut të vlerësuar në atë kohë

Shtojca A jep hollësitë e shumave të përfshira në Buxhetin e KEK-ut për 2010, të cilat janë përdorur edhe për aplikacionin për tarifë. Shtojca B paraqet informacion të përditësuar për 2010 në bazë të Bilancit Përfundimtar të Energjisë dhe një pajtim në mes të vlerave të KEK-ut dhe KOSTT-it. Sigurisht, nëse ZRrE-ja i zvogëlon tarifën e KOSTT-it, shuma do të jetë më e ulët dhe nëse ZRrE-ja ngrit tarifën e KOSTT-it, shuma që do të përfshihet në tarifën me pakicë të KEK-ut do të jetë më e lartë. Bazuar në tarifën e tanishme të KOSTT-it, megjithatë, të Hyrat e Lejuara të KEK-ut duhet të përfshijnë:

- **€ 5,772,000** për taksë për Operator të Sistemit dhe Operatori i Tregut që duhet të paguhet nga Gjenerimi I KEK-ut. Sigurisht, kjo sasi përfshin Vlerën e Shtuar të taksës (TVSH), siç kërkohet nga ligji i Kosovës,
- **€ 19,749,000** për Operatorin e Sistemit, Operatorin e Tregut, dhe Përdorimin e Transmisionit për Sistemin e pagesave që duhet të paguhet nga Furnizimi i KEK, duke përfshirë edhe TVSH-në e nevojshme.
- **€ 5,196,000** kredi për të ardhurat nga shitja e energjisë për KOSTT-it për të mbuluar humbjet e transmisionit. Kjo është shuma që KOSTT-it pritet t'i paguajë KEK-ut dhe shuma që do të regjistrohen si të ardhura të KEK-ut në përputhje me kërkesat e kontabilitetit (neto e TVSH-se që duhet të l kthehet Qeverisë).

Në tabelën 3 të Dokumentit të Konsultimit, duket se ZRrE-ja është duke përfshirë vetëm një shumë neto prej € 12.497.000 në tarifën me pakicë në lidhje me KOSTT-in. Shuma e mësipërme e dokumentuar prej 5.772.000 € për tu paguar nga Gjenerimi KEK, 19.749.000 € për tu paguar nga Furnizimi KEK, kompensuar nga të ardhurat prej 5.196.000 € për një shumë neto prej € 20.325.000 janë të nevojshme për t'u përfshirë në të ardhurat e lejuara të KEK-ut dhe tarifën që rezultojnë me pakicë, në mënyrë që të reflektojnë koston e transmetimit në formë të drejtë. **Shuma e ZRrE-së prej 7.828.000 € në Dokumentin e Konsultimit është shumë e ulët.** Sigurisht, që kjo është e bazuar në tarifën aktuale të miratuar për KOSTT-it. Nga ZRrE-ja. Nëse tarifën e KOSTT-it janë

ndryshuar nga ZRrE-ja si rezultat i këtij shqyrtimi të tarifave, shumat duhet të rishikohen për të pasqyruar tarifën e reja.

Qëllim i KEK-ut është për të paguar KOSTT-it çdo muaj në bazë të tarifave të miratuara nga ZRrE-ja. Megjithatë, KEK-u nuk ka burime financiare për të paguar KOSTT-it më shumë se shumën e përfshirë në të hyrat e lejuara të KEK-ut. KEK-u nuk do të paguajë shumën më të madhe KOSTT-it se ato të përfshira në tarifën e shitjes me pakicë. KEK-u nuk dëshiron të jetë në pozitë sic ishte në shqyrtimin e fundit të tarifave kur tarifën e KOSTT-it u rritën me gati 40%, ndërsa tarifën e KEK-ut u rritën me vetëm 2% ½.

ÇËSHTJA: Shpenzimet për Borxhet e Këqija

Qendrimet e KEK-ut dhe ZRrE-së në këtë çështje janë të qarta. KEK-u ka përfshirë € 3.2 Milion në të Hyrat e lejuara si një Lejim për Borxhet e Këqija. Çdo biznes që nuk kërkon pagesë në ose para dorëzimit të produktit ose shërbimit ballafaqohet me një nivel të shpenzimeve të borxhit të keq. Shumën e kërkuar të KEK-ut për t'u përfshirë në të Ardhurat e lejuara është 2% e të ardhurave të faturuara, një pjesë e vogël e shpenzimeve të € 25.6 Milionëve të borxhit të keq të paraqitur në llogaritë paraprake financiare më 2009. KEK-u ka ndërmarrë hapa për të zvogëluar shpenzimet e borxhit të keq. Në vitin 2009, KEK-u u ballafaqua me 19% të shpenzimeve të borxhit të keq në krahasim me 25% në vitin 2008.

ZRrE-ja refuzon të njohë realitetin e biznesit / komercial për këtë pikë, duke rezultuar në një reduktim të propozimit për të Ardhura e lejuara të KEK-ut për € 3.2 Milion .

ÇËSHTJA: Të hyrat nga Shërbimet Ndihmëse

ZRrE-ja ka ulur të hyrat e lejuara të KEK-ut për € 1.6 milion në pritje që KOSTT-i do të paguaj KEK-un për Shërbimet ndihmëse në përputhje me një projekt kontratë e cila nuk është ende në fuqi. KEK-u mbështet plotësisht përpjekjet e KOSTT-it për të lejuar që Kosova të bëhet një zonë e kontrollit dhe qëllimin e kontratës është për të marrë një hap në këtë drejtim. Çmimi në këtë kontratë nuk është miratuar ende nga ZRrE-ja. Nëse ZRrE-ja parashikon miratimin e çmimit në kontratë duke hyrë në fuqi nga 01 prilli 2010 (si pjesë e këtij rendi të tarifave) atëherë shumën e përshtatshme për të përfshirë si një reduktim të të ardhurave të lejuara për vitin 2010 të KEK-ut do të jetë 9 / 12 prej € 1.6 Milion ose € 1.2 Milion.

ÇËSHTJA: Blerja e energjisë nga Hidro Centralet

KEK-u ka përfshirë blerjet nga hidro centralet në çmimet e kontratës përkatëse si vijon:

- Blerje nga Ujmani për 68 GWh sipas Bilancit të Energjisë në çmim të kontratës prej 27,5 € për MWH për një kosto prej 1.870.000 €
- Blerje nga Lumbardhi për 23,728 GWh sipas Bilancit të Energjisë në çmim të kontratës prej € 40 për MWH për një kosto prej 948.000 €

Kjo rezulton në një kosto prej € 2.818.000. Në Dokumentin e Konsultimit ZRrE-ja tregoi se KEK-u në mënyrë jo të drejtë ka caktuar çmimin e Lumbardhit në € 50 per MWH, dhe ZRrE-ja është duke propozuar një reduktim në të Hyrat e lejuara prej € 237,000. Meqë KEK-u ka çmimuar këtë energji në mënyrë të drejtë, është e qartë që reduktimi është i papërshtatshëm.

Pas shqyrtimit të mëtejshëm të blerjeve nga hidroelektranat, meqë KEK-u duhet të paguajë çmimin e kontratës plus TVSH-ne për çdo faturë, është e qartë se të hyrat e

lejuara gjithashtu duhet të rriten me € 451.000 (16% prej € 2.818.000) për të mbuluar këtë tatim të kërkuar.

ÇËSHTJA: "Azhustimet" e prezentuara nga ZRr-eja në Dokumentin e Konsultimit

Tabela 1 tregon se ZRRE-ja ka bërë azhustime në shumën prej € 3.187 milion. Shpjegim i është dhënë KEK-ut për një reduktim prej € 1,0 Milion në të Hyrat e lejuara për një pjesë të taksave të licencës që nuk është vlerësuar nga ZRE-ja në vitin 2009. KEK-u pajtohet me këtë azhustim, por nuk është në gjendje të komentoj mbi reduktimin e mbetur prej € 2.187 Milion. Nga ZRrE-ja kërkohet t'i sigurojë KEK-ut letrat e saja të punës dhe dokumentacionin për këtë shumë. KEK-u nuk pajtohet me qëndrimin e ZRRE-së se niveli i shpërndarjes së humbjeve teknike prej 17,5% të përfshira në bilancin e energjisë nuk është vlerë e përshtatshme për tu përfshirë në tarifa. ZRRE-ja pranon se vlera aktuale në 2009 ishte 18%, por këmbëngul se niveli prej 17,1% i vendosur në vendimin paraprak për tarifa është më e përshtatshme për t'u përdorur për vitin 2010. Ky azhustim mund të jetë pjesë e € 2.187 million të reduktimit të pidentifikuar por KEK-u nuk u ka dhënë dokumentacioni për të mbështetur atë. Zvogëlimi i humbjeve teknike ndodh gradualisht me kalimin e kohës kur bëhen shtesa dhe përmirësime në rrjet dhe KEK-u dhe kërkon nga ZRrE-ja për të njohur këtë fakt.

Transmission Related Expenditures Included in KEK's Tariff Application

Based on the draft of Energy Balance for year 2010 of the date 01.10.09 was foreseen the budget for Obligation of KEK and KOSTT

| | 2010 | TC"A" | TC"B" |
|------------------------|-----------|-----------|-----------|
| Production (MWh) | 4 610 100 | 1 410 400 | 3 199 700 |
| Supply (MWh) | 4 757 356 | | |
| Losses (MWh) | 170 600 | | |
| TLF | 1.0438 | | |
| Peak in 400/220kV (kW) | 39 300 | | |
| Peak in 110kV (kW) | 847 700 | | |

| | Net (€) | PRICES |
|---|--------------|------------------|
| 1. TUOS (Use of Trans. Network.) 400/220kV | 182 194.80 | 4.636 €/MWh/vit |
| 2. TUOS (Use of Trans. Network) 110kV | 8 556 683.80 | 10.094 €/MWh/vit |
| 3. Obligation of Supply for Market Operation | 95 147.12 | 0.02 €/MWh |
| 4. Obligation of Supply for System Operation | 5 076 098.85 | 1.067 €/MWh |
| 5. Obligation for System Operation fee of generator - TC"A" | 1 504 896.80 | 1.067 €/MWh |
| 6. Obligation for System Operation fee of generator - TC"B" | 3 414 079.90 | 1.067 €/MWh |
| 7. Obligation for Market Operation fee of generator - TC"A" | 28 208.00 | 0.02 €/MWh |
| 8. Obligation for Market Operation of generator - TC"B" | 63 994.00 | 0.02 €/MWh |
| 9. Obligations of KOSTT to purchase energy to cover losses | 5 339 780.00 | 31.3 €/MWh |

Net Obligations

- I. Total obligations of KEK towards KOSTT(1+2+3+4+5+6+7+8)
- II. Obligations of KOSTT towards KEK for transmission losses(9)
- III. Saldo Net Obligations of KEK towards KOSTT (I-II)

Gross Obligations

- I. Total Obligations of KEK towards KOSTT(1+2+3+4+5+6+7+8)
- II. Obligations of KOSTT towards KEK for transmission losses(9)
- III. Saldo Net obligations of KEK towards KOSTT (I-II)

| | SUMMARY | Net of VAT | Including VAT |
|----------------------------------|---------|-------------|---------------|
| KOSTT Fee - Generators | | 5,011,179 | 5,812,967 |
| KOSTT Fee - Load Customers | | 13,910,125 | 16,135,745 |
| Total KOSTT Fee | | 18,921,303 | 21,948,712 |
| Sale of Energy to KOSTT (Losses) | | (5,339,780) | (6,194,145) |

Transmission Related Expenditures for 2010 Restated based on Final Energy Balance

| Obligimet e KEK dhe KOSTT në bazë të Bilancit Energjetik per vitin 2010 | | TC"A" | TC"B" |
|---|-----------|-----------|-----------|
| | 2010 | 1 410 400 | 3 167 300 |
| Prodhimi (MWh) | 4 577 700 | | |
| Furnizimit (MWh) | 5 177 400 | | |
| humbjet (MWh) | 166 000 | | |
| TLF | 1,0438 | | |
| Piku ne 400/220kV (kW) | 61 800 | | |
| Piku ne 110kV (kW) | 962 910 | | |

| | Neto (€) | çmimet |
|--|--------------|------------------|
| 1. TUOS (Shfrytezimi i Rrjetit Trans.)meTVSH 400/220kV | 286 504.80 | 4.636 €/MWh/vit |
| 2. TUOS (Shfrytezimi i Rrjetit Trans.)meTVSH 110kV | 9 719 613.54 | 10.094 €/MWh/vit |
| 3. Detyrim i Furnizimit per OT | 106 868.00 | 0.02 €/MWh |
| 4. Detyrimi Furnizuesit per OS | 5 701 407.80 | 1.067 €/MWh |
| 5. Detyrim per Operim te Sistemit i gjeneratorit - TC"A" | 1 504 896.80 | 1.067 €/MWh |
| 6. Detyrim per Operim te Sistemit i gjeneratorit - TC"B" | 3 379 509.10 | 1.067 €/MWh |
| 7. Detyrim per Operim te Tregut i gjeneratorit - TC"A" | 28 208.00 | 0.02 €/MWh |
| 8. Detyrim per Operim te Tregut i gjeneratorit - TC"B" | 63 346.00 | 0.02 €/MWh |
| 9. Obligimet e KOSTT ndaj KEK per humbje me TVSH | 5 195 800.00 | 31.3 €/MWh |

Neto obligimet

| | |
|---|---------------|
| I. Total Obligimet e KEK ndaj KOSTT(1+2+3+4+5+6+7+8) | 20 790 354.04 |
| II. Obligimet e KOSTT ndaj KEK per humbjet ne Transmission(9) | 5 195 800.00 |
| III. Saldo Obligimet e KEK ndaj KOSTT (-II) | 15 594 554.04 |

Bruto obligimet

| | |
|---|---------------|
| I. Total Obligimet e KEK ndaj KOSTT(1+2+3+4+5+6+7+8) | 24 116 810.69 |
| II. Obligimet e KOSTT ndaj KEK per humbjet ne Transmission(9) | 6 027 128.00 |

Pas reconsulimit te Pikut per vitin 2010

| | |
|--|--------------|
| | 1 210 350.68 |
|--|--------------|

k

0.05822

| SUMMARY | | € | |
|------------------|-------------|---------------|--|
| | Neto of VAT | Including VAT | |
| Generators fee | 4,975,960 | 5,772,113 | |
| Supply fee | 17,024,745 | 19,748,704 | |
| Total KEK oblig. | 22,000,705 | 25,520,817 | |
| KOSTT oblig to | 5,195,800 | 6,027,128 | |